

L I G J
Nr.8540, datë 21.10.1999

**PËR RATIFIKIMIN E “MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR KRIJIMIN E
LEHTËSIRAVE PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE NË
RAJONIN E SECI-T”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve e marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Memorandumi i mirëkuptimit për krijimin e lehtësirave për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave në rajonin e SECI-t”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2470, datë 28.10.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
PËR LEHTËSIMIN E TRANSPORTIT NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE NË
RAJONIN E SECI-T

Në kuadrin e iniciativës së SECI-t, si dhe mbështetjen e Qeverisë Greke dhe të Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara të Komisionit Ekonomik Europian (UN/ECE), Konferenca Europiane e Ministrisë së Transportit ECMT, përfaqësuesit e Qeverisë së vendeve pjesëmarrëse në SECI dhe Komisioni Europian që më poshtë do të quhen palë:

Me dëshirën për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet vendeve pjesëmarrëse në iniciativën SECI, me synim të lehtësojnë transportin dhe tregtinë, gjë që është esenciale për zhvillimin ekonomik të rajonit;

Duke njohur ekzistencën e shumë mangësive në operimin e transportit ndërkombëtar rrugor në vendet e Europës Juglindore, të cilat janë rezultat jo vetëm i mungesës së infrastrukturës së përshtatshme dhe procedurave të kalimit kufitar, por edhe barrierave institucionale ekonomike dhe rregullatore;

Duke theksuar faktin që zgjidhja e problemeve të tilla të përbashkëta kërkon një afim të ri dhe të rinovuar në kuadrin e bashkëpunimit rajonal;

Të vetëdijshëm për angazhimet e tyre që rrjedhin nga miratimi i Marrëveshjeve dhe Deklaratave të rëndësishme ndërkombëtare;

Duke shprehur gatishmërinë e tyre për të vënë në zbatim dhe/ose për të marrë në konsideratë në mënyrën më të përshtatshme, vendimet e marra dhe aktet ligjore të miratuara në fushat e transportit, veçanërisht në transportin rrugor dhe të ambientit në kuadrin e Konferencës Europiane të Ministrave të Transportit (ECMT), Bashkimit Europian (EC) Kombeve të Bashkuara kryesisht të sekretariatit të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Europën dhe në forume dhe marrëveshje ndërkombëtare të rëndësishme;

Të bindur që shpenzimet e kryera dhe masat e marra në kohë efikase do të çojnë në rritjen

cilësore të sektorit të transportit rrugor në rajon;

Të vetëdijshëm për rolin e kombinuar që mund të luajë transporti për të pasur shërbime efikase transporti në rajon;

Të ndërgjegjshëm në faktin që disa masa mund të zbatohen vetëm në afate të largëta kohore;

Bien dakord për Memorandumin e Mirëkuptimit (MOU) të mëposhtëm si një hap i rëndësishëm drejt lehtësimit të transportit rrugor ndërkombëtar të mallrave.

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Memorandumi është të zgjerohet bashkëpunimi dhe koordinimi i shteteve pjesëtare të SECI-t drejt harmonizimit të disa elementëve kyç, që do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit të transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave në këtë rajon, në përputhje me rregullat dhe standardet ndërkombëtare, me fjalë të tjera nëpërmjet formaliteteve, dokumentacionit dhe procedurave thjeshtëzuese dhe harmonizuese.

2. Ky bashkëpunim do të përqendrohet kryesisht në zhvillimin e politikave të bazuara në parimet, mjetet e veprimtaritë e përbashkëta të një karakteri institucional, rregullator dhe ekonomik, si dhe në mjetet me mënyrat e zbatimit dhe monitorimit të tyre.

Neni 2

Rregullat e përgjithshme

1. Palët nuk duhet të adaptojnë masa me kushte më pak të favorshme se sa ato të përfshira në Marrëveshjet Bilaterale ekzistuese, Marrëveshjen Europiane, EN ECE dhe Marrëveshje të tjera të UN dhe Konventa, Rezolutat e ECMT etj. Në veçanti palët zbusin barrierat ose pengesat administrative, teknike legale, si dhe pengesa të tjera me mendimin për të lehtësuar transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave duke siguruar një efikasitet të përbashkët bilaterale dhe transport tranzit nëpër territoret e tyre, në përputhje me standardet ndërkombëtare të miratuara nga instrumente legale duke u siguruar që taksat e zbatuara në mjetet e transportit të reflektojnë koston reale të transportimit, të bazuar në politikat e harmonizuara të tekstit me elementet standard për llogaritjen e kostove.

2. Kushtet e këtij MOU nuk do të ndikojnë në të drejtat dhe detyrimet e palëve, që lindin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, në të cilat ato janë palë ose mund të bëhen të tilla.

Neni 3

Liberalizimi progresiv dhe qëndrueshmëria e transportit ndërkombëtar rrugor

1. Palët do të vendosin gradualisht, në përputhje me vendimet që do të zbatohen në komunitetin europian një hyrje të lirë në treg për transportin rrugor ndërkombëtar.

2. Duke pranuar që hyrja e lirë në treg sipas paragrafit 1 do të jetë një objektiv afatgjatë për disa nga palët, në fazën e parë, palët vetë do të vendosin një regjim kuotash falas të lejeve për transportin rrugor të mallrave bilaterale dhe tranzit. Lejet mund të kërkohen për qëllime administrative dhe statistikore. Operacionet e transportit të vendeve të treta dhe të kabotazhit janë të përjashtuara nga regjimi i kuotave falas.

3. Si masë afatshkurtër regjimi i kuotave falas do të aplikohet nga fundi i vitit 2000 për mjetet rrugore të mallrave “të gjelbëra” dhe “të gjelbëra e të sigurta” në përputhje me përkufizimet e ECMT. Me shumë detaje për implementimin e këtij regjimi falas lejesh do të përgatitet nga Komiteti siç parashikohet nga artikulli 12.

4. Ky regjim falas lejesh nuk do të cenojë përfitimet e arritura nga Marrëveshjet bilaterale në fuqi mes palëve deri kur përfshihen lejet falas. Gjithashtu, nuk do të cenojë të drejtat e pavarura të palëve për të kërkuar pagesën e taksave doganore dhe taksave të tjera rrugore.

5. Palët do të paraqesin, do të përshtasin dhe do të përkrahin shërbimet e kombinuara adekuate duke siguruar kështu kapacitetet shtesë dhe plotësuese për transportin rrugor ndërkombëtar për sektorë të caktuar për korridoret kryesore të transportit ndërkombëtar në rajonin e SECI-t.

Neni 4

Hyrja në marrëveshjet ndërkombëtare

Palët do të synojnë të aderojnë, nëse ato nuk e kanë bërë akoma në marrëveshjet ndërkombëtare të transportit nën patronazhin e UN/ECE sipas aneksit të këtij Memorandumi.

Neni 5

Harmonizimi i përmasave dhe peshave maksimale të lejuara, si dhe procedurat e peshimit

Palët duhet të synojnë të harmonizojnë kërkesat e tyre kombëtare për maksimumin e përmasave dhe peshave të lejueshme për mjetet rrugore të mallrave në përputhje me ato rregulla që janë në fuqi sipas Komunitetit Europian (EC), si dhe për procedurat e peshimit. Palët marrin përsipër të synojnë kryerjen e veprimeve në favor të harmonizimit të procedurave të peshimit.

Neni 6

Rrugët që shërbejnë për trafikun ndërkombëtar (rrugët - E)

1. Palët do të identifikojnë rrugët e të gjitha rrugët-E që i shërbejnë trafikut ndërkombëtar që janë të lejueshme për përdorimin e mjeteve rrugore të mallrave sipas rregullave të Komunitetit Europian (E.C), ku peshat dhe përmasat në rrugët ndërkombëtare të transportit janë të përcaktuara në një listë që i shtohet si Protokoll këtij Memorandumi. Palët do të përcaktojnë ato seksione në rrjetin e rrugëve-E, të cilat nuk janë akoma në përputhje me rregullat e sipërpërmendura të E.C-së dhe do të përpiqen t'i përmirësojnë këto seksione.

2. Komiteti mund të marrë në shqyrtim të përshtasë dhe të modifikojë, në rast nevojë, Protokollin e këtij MOU mbi bazën e propozimeve të palëve.

Neni 7

Certifikata e peshës së mjeteve rrugore të mallrave ndërkombëtare sipas SECI-t

Palët do paraqesin certifikatën e peshës të SECI-t për kamionët të lëshuara nga autoritetet përkatëse me qëllim ndalimin e matjeve të përsëritura të peshave të mjeteve rrugore të mallrave kur janë në rrugë. Përdorimi i këtyre certifikatave nga operatorët e transportit është fakultativ. Procedurat e detajuara për hartimin e certifikatës, përdorimin e saj sikurse të gjitha masat e nevojshme që do të merren nga autoritetet kompetente do të përfshihen në protokollin e kësaj MOU dhe do të miratohen në Komitet si parashikohet në nenin 12.

Neni 8

Politikat e taksimeve

1. Palët bien dakord që të hedhin të gjitha hapat e duhur drejt racionalizimit dhe konvergimit të politikave të taksimeve për transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave, duke marrë në konsideratë parimet e kostos reale të mosdiskriminimit dhe transparencës.

2. Palët duhet të sigurojnë që taksat rrugore dhe forma të tjera taksash nuk mund të vendosen në të njëjtën kohë për përdorimin e të njëjtit seksion rrugë. Taksa të tilla të vendosura për transportuesit duhet të jenë në përputhje me elementet e standardeve të njohura ndërkombëtare për llogaritjen e kostos së transportit rrugor për njësi (ton-km). Taksat respektive duhet të paguhen në monedhën e vendit ose në atë ndërkombëtare.

3. Mjetet që transportojnë mallra në përputhje me rregullat e Komunitetit Europian (EC) përsa i përket dimensionit dhe peshës maksimale për mjetet rrugore të mallrave nuk do të taksohen për peshën e tepërt dhe/ose për dimensionet në ato seksione të rrjetit të rrugëve europiane që janë bërë të njohura sipas nenit 6 të Protokollit të këtij Memorandumi, përgatitur ng Komiteti sipas nenit 12.

Neni 9

Sistemi i informacionit për taksat lidhur me transportin rrugor

Palët do të synojnë të sigurojnë një informacion të plotë, të saktë, të kohës së caktuar për të gjitha pagesat, taksat në lidhje me përdorimin e rrjetit kombëtar të rrugëve nga operatorët e huaj, duke përfshirë këtu informacionin paraprak të çdo modifikimi, para se këto informacione të hyjnë në fuqi. Palët ftojnë sekretariatet e UN/ECE në bashkëpunim me Bashkimin e Transportit Rrugor Ndërkombëtar për të botuar këtë informacion për propagandimin e përdoruesve të interesuar.

Neni 10

Lehtësimi i procedurave të vizave për shoferët profesionistë

Palët do të nxisin autoritetet respektive për të kërkuar rregullisht mundësitë për të lehtësuar dhënien e vizave për shoferët profesionistë të angazhuar në transportin rrugor ndërkombëtar me qëllim thjeshtëzimin e formaliteteve, kufizimin e numrit të dokumenteve bazë, pakësimin e kohës që duhet për të marrë viza dhe nxjerrjen e vizave shumëfishe hyrjeje të vlefshme për një vit pa cenuar marrëveshjet ekzistues.

Neni 11

Procedura e zbatimit

1. Palët do të synojnë të zbatojnë kushtet thelbësore të këtij Memorandumi duke i vënë në praktikë sipas marrëveshjeve dypalëshe ose pritët të bëhen për transportin rrugor, si dhe nga protokollet e mbajtura të shteteve pjesëmarrëse të SECI-t. Ky proces do të mbyllet në fund të vitit 2000.

2. Palët bien dakord të përpiqen për një Marrëveshje rajonale (multilaterale) të transportit rrugor që të përfshinë masat shtesë të nevojshme për rritjen e kapaciteteve të transportit dhe promovimin e teknologjive që ruajnë mjedisin në të gjitha shtetet përfaqësuese të SECI-t, ku lehtësitë nuk duhet të jenë më pak favorizuese sesa të dhëna në këtë Memorandum dhe duhet të reflektojnë praktikën më të mira e më të suksesshme, të pasqyruara në marrëveshjen bilaterale të transportit rrugor.

Neni 12

Mekanizmi institucional

1. Palët bien dakord të krijojnë një Komitet Rajonal të Transportit Rrugor që të përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve kompetente nga të gjitha vendet përfaqësuese të SECI-t që të sigurojnë një zbatim (koordinim) adekuat dhe të monitorojnë zbatimin e kushteve të këtij Memorandumi në rajon, si dhe të sigurojnë zbatimin e mundshëm të Marrëveshjes rajonale (multilaterale) të transportit rrugor, sipas nenit 11, duke përfshirë këtu edhe rregullat për transportin e pasagjerëve. Përfaqësuesit e shteteve dhe të institucioneve si përkrahëse të SECI-t dhe organizatat dhe institucionet e interesuara përfshirë PRO Komiteteve kombëtare mund të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit Rajonal në nivel konsultativ.

2. Takimi i parë i Komitetit Rajonal do të bëhet gjatë vitit 1999 nga Qeveria Greke për të marrë në shqyrtim progresin e arritur, në zbatim të këtij Memorandumi. Më pas Komiteti do të mbledhet për të përgatitur Protokollin sipas nenit 6 dhe 7. Komiteti do të jetë pritës dhe do të mbledhet të paktën një herë në vit ose sa herë është e nevojshme nga një prej shteteve pjesëmarrëse të SECI-t. Komiteti do të vendosë rregullat e veta procedurale. Fillimisht Sekretariati i UN/ECE do të veprojë për shërbimet e sekretarisë së komitetit.

Neni 13

Kohëzgjatja

Ky Memorandum është në fuqi për 5 vjet, afati i tij do të zgjatet për më tepër se 5 vjet, nëse asnjëra nga palët nuk kundërshton së paku një vit para se të mbarojë afati i 5 viteve.

Neni 14

Vendimi final

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë pas nënshkrimit nga 6(gjashtë) palët. Ky Memorandum i përpiluar në anglisht në dhjetë kopje origjinale do të depozitohet në arkivat e palëve që kanë firmosur.

Ky kooperim është i bazuar në një bashkim vullnetar. Nëse ka ndonjë kërkesë nga secila prej palëve, ky Memorandum mund të rishikohet.

Shtete të tjera mund të bëhen palë në këtë Marrëveshje me miratimin e të gjithë palëve firmosëse.

Firmosur në Athinë më 28 prill 1999 nga qeveritë e shteteve pjesëmarrëse në SECI .